



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

Prishtinë

09.07.2015
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A-Su.A _____ 218/2015
Dt: _____ 10.07.2015
PRISHTINË - PRISTINA

Kolegiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 09.7.2015, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Kur prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë pa i zbatuar hetimet, për veprë penale për të cilën ligji parasheh dënim mbi tri vite burgim, atëherë aktakuza e tillë konsiderohet e parregullt dhe duhet t'i kthehet prokurorit që t'i zbatojë hetimet para akuzimit, dhe nëse prokurori ia kthen pa i zbatuar fare hetimet, atëherë aktakuza hedhet, sipas nenit 442 par. 3. dhe 4. i KPPK-së.

Arsyetimi

Gjykatës Supreme i është drejtuar me kërkesë për të dhënë mendim juridik, Gjykata Themelore në Gjilan, lidhur me atë se si duhet vepruar gjykata kur prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë për vepra penale, për të cilat me ligj parashihet dënim mbi

tri(3) vite burgim, dhe në kërkesë ka parashtruar këto pyetje: sipas cilës dispozitë duhet vepruar nëse prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë pa i zbatuar fare hetimet për vepra penale, për të cilat me ligj, mund të shqiptohet mbi tri (3) vjet burgim, sipas nenit 442. par. 3. dhe 4. të KPPK-së, apo nenit 245 dhe 250 të KPPK-së.

Procedura penale, përfshinë tri stade: Procedurën paraprake, e cila ka tri faza hetimin, akuzimin, dhe shqyrtimin e aktakuzës, stadi i dytë - shqyrtimi gjyqësor dhe stadi i tretë- procedura sipas mjeteve juridike.

Aktakuza, parimisht ngritet vetëm pas zbatimit të hetimeve, përjashtimisht për vepra penale, për të cilat ligji parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në tri vjet, ajo mund të ngritet edhe pa zbatuar hetimet, nëse kallëzimi penal është i mbështetur në të dhëna që vejnë në një shkallë të lartë të besueshmërisë dyshimin e parashtruar, neni 101. par. 2. i KPPK-së (“dyshimi i *bazuar mirë*”, *këtë shprehje ka përdorur ligjdhënësi*).

Po ju referuam normës, nenit 101. par. 2. të KPPK-së, rezulton qartë se aktakuza nuk mund të ngritet pa u zhvilluar hetimet, për vepra penale, për të cilat sipas ligjit, mund të shqiptohet dënim mbi tri (3) vite burgim, pavarësisht se në çfarë prova, të dhëna është i mbështetur kallëzimi penal. Në situatën e tillë, aktakuza konform nenit 442. par. 4. i KPPK-së, duhet t’i kthehet prokurorit të shtetit që ta plotësojë atë, d.m.th., që aktakuza të jetë rezultat i procedurës së hetuesisë dhe nëse prokurori nuk vepron sipas urdhrit të gjyqtarit-kryetarit të trupit gjykues, atëherë aktakuza hedhet sipas nenit 442 par. 4. i KPPK-së.

Gjykata cakton shqyrtimin e aktakuzës për vepra penale për të cilat mund të shqiptohen mbi tri(3) vjet burgim, vetëm kur vlerëson se ajo është e rregullt, mirëpo

nëse aktakuzës nuk i ka paraprirë procedura e hetuesisë për vepra të këtilla penale, ajo konsiderohet e parregullt dhe nuk mund të shkohet në shqyrtimin e saj.


Kur kemi të bëjmë me vepra penale, për të cilat sipas ligjit, nuk mund të shqiptohet dënim mbi tri (3)vjet burgim, prokurori përjashtimisht (*jo çdo herë sipas një vlerësimi abstrakt*) mund të ngritë aktakuzë pa hetime, vetëm nëse të dhënat e paraqitura e bëjnë dyshimin për ta mbështetur aktakuzën mirë të bazuar. Nëse sipas vlerësimit të gjykatës, dyshimi nuk është i bazuar mirë (*në shkresat e çështjes nuk ka prova të qarta*), ajo mund t'i kthehet prokurorit që të zhvillojë hetime, dhe nëse prokurori nuk vepron sipas urdhrorit të gjykatës dhe e kthen të njëjtën aktakuzë (*pa zbatuar hetimet*), në situatën e tillë, gjykata nuk e hedh aktakuzën si të parregullt, sikundër vepron te rastet kur aktakuza është ngritë pa hetime, *për vepra penale, për të cilat me ligj mund të shqiptohen mbi tri (3) vjet burgim*, por cakton shqyrtimin e aktakuzës, dhe mund ta hedh atë konform nenit 250. par. 1. pika 1.4. të KPPK-së.

Nëse gjyqtari-kryetari i trupit gjykues, në situata të tilla nuk vepron sipas nenit 442. par. 4. i KPPK-së, por shkon në shqyrtim të aktakuzës, atëherë çështja do duhej të gjykohej pa hetim fare, ngase nuk ekziston asnjë nga shkaqet për hedhjen e aktakuzës nga neni 253 të KPK-s(*nuk mund ta hedh aktakuzën për mungesë provash, ngase është e qartë se vjedhja është kryer, vrasja është kryer, përkatësisht është shkaktuar vdekja e të ndjerit në aksident trafiku etj.*). Në situatën e tillë do kishim një aktgjykim me të meta, ashtu që në procedurën me mjete juridike domosdoshmërisht vendimi do anulohet për defekte procedurale, (*mungesë e një faze të procedurës –fazës së hetuesisë*), kjo do sillte te zvarritja e panevojshme e çështjeve.

Qëllimi i hetimit është për t'i sqaruar dimensionet tjera të ngjarjes dhe ligjërisht në asnjë mënyrë nuk mund të ngritët aktakuzë për vepra penale që ligji parasheh dënim mbi tre vjet burgim, pa i zbatuar hetimet.

Aktakuza e tillë nuk mund të shqyrtohet sipas nenit 245., por ajo duhet të kthehet konform nenit 442 par. 4. për plotësim (për zbatimin e hetimeve) dhe nëse nuk veprohet sipas urdhrit, duhet të hidhet si e parregullt.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani


Ne Jusg uion

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës